

LIRI BRAHIMI
ISHIM NE...

BOTIMET TOENA

Liri Brahimi

ISHIM NE...

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2016

Botuese: Irena Toçi
Kryeredaktore: Sonila Kapo
Redaktor: Kujtim Dashi
Korrektore letrare: Petrina Ago
Përkujdesja grafike: Elida Stafa
Kopertina: Albana Kuraj Gega

ISBN 978-9928-205-59-9

© Autorja

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi i materialeve që përmban ky libër me asnjë mjet apo formë, as me fotokopje, as pjesërisht, pa lejen me shkrim të Botimeve Toena.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësia", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116; 22 58 893

Fax: +355 4 22 40 117

E-mail: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

[Http://www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

Me çfarë fillon kujtesa ime?!... Sa shumë që kam punuar, sa shumë jam lodhur, për të krijuar individualitetin tim në art. Memoria ime fillon pikërisht me krijimtarinë time artistike. Unë me shpirt isha artiste e mbrujtur e tëra me art. Kurrë nuk do të humbisja sepse rrihte pulsi i artistit: tik-tak... Por ama nuk mungonte edhe puna këmbëngulëse, nuk thoshte kot Stanislavski: “Një herë talent, dhjetë herë punë”.

Në vitin 1955 studioja në Liceun Artistik në degën e Artit Dramatik. Thoshin që isha e talentuar. Recitoja në koncerte shtetërore, duke përfaqësuar degën e dramës. Isha e lidhur ngushtë me tre shokët e mi: Behxhet Nelku, Serafin Fanko dhe Viktor Bruçeti. Të gjitha skeçet, etydet i zhvillonim bashkërisht që të katër. Edhe më pas, kur mbaruam Liceun ne u bashkuam prapë të katërt në Akademinë e Arteve. Pedagogia ruse Nina Çefranova gjithmonë shprehej:

“Nuk e di se çfarë duhet t’u jap këtyre të katër studentëve, këta i kanë marrë të gjitha...”.

Aq e re sa isha dhe punoja shumë. Qysh në vitin e parë të Liceut Artistik më kishin zgjedhur për të transmetuar lajmet

në Radio-Tirana. Madje incizoja dhe emisione të ndryshme me Alfons Gurashin. Radio-Tirana në atë kohë kishte dy spikerë të talentuar dhe tepër të veçantë: Vera Zheji dhe Haki Bejleri. Këta përfaqësonin zërin e Shqipërisë brenda dhe jashtë atdheut. Unë sa herë që jepja lajmet mundohesha ta imitoja Verën. Por sa sakrificë që bëja! Do të thoni ju, pse? Ja, t’jua tregoj: unë banoja në rrugën “Gjon Muzaka”, Nr. 46; kishim shtëpinë tonë. Duhej që shumicën e rasteve të jepja lajmet e mëngjesit. Duhej të nisesha në orën pesë të mëngjesit. Me shpejtësi vishja përparësen e zezë të shkollës; rrëmbeja çantën e librave, merrja një tufë me kaushë gazete dhe shkrepësen, të cilat i bëja gati që në darkë. Mamaja ime e bënte këtë sakrificë, ajo me kaushët e ndezur më përcillte deri te stabilimenti sepse aty niste një ndriçim tek-tuk i vakët. Atëherë me çantë në dorë ia veshja vrapit. Sapo mbërrija në radio futesha në studion e transmetimit dhe bëja hapjen e emisioneve të mëngjesit. Nuk e harroj një ditë në mëngjes, pasi bëra mbylljen e emisioneve në orën 8:00 rrëmbeva çantën dhe hapa derën, por pa pandehur u përballa me drejtorin, Thanas Nano edhe me një të huaj, së bashku me një përkthyes të radios

- Ja, - i tha drejtori, - kjo është spikerja.

U dëgjua një e qeshur e madhe e personit të Radio-Berlinit, i cili shtoi:

- Çudi! Një zë kaq shumë i pjekur në një moshë kaq të vogël.

Ata u futën në studion e transmetimit, kurse unë ia veshja vrapit për në shkollë - Liceu Artistik ndodhej në fund të *Rrugës së Kanajës*. Ecja me vrap, që brenda orës 8:05 të ndodhesha në klasë. Për fatin e mirë, Liceu Artistik, Radio-Tirana dhe shtëpia ime, ndodheshin që të tria në një rrugë. Kështu që e

gjithë dita më shkonte duke fuguar, nga shtëpia në Radio, nga Radio në Lice dhe nga Liceu në shtëpi. Këtë rrugë e bëra vite me radhë, edhe kur studiova në Akademinë e Arteve, edhe kur dola aktore në vitin 1965.

Kur merrija pagesën një herë në muaj, dhe që ma bënë shumë të mirë, njëqind lekë në orë, lekët i mbaja në grusht fort dhe, sapo mbërrija në shtëpi, ia dorëzoja mamasë. Ajo më pyeste:

- Sa lekë do të mbash?

- Dhjetë lekë...

Ajo m'i jepte dhe unë fugoja te një ëmbëltore te *Rruga e Kanajës*. Aty blija dy kuleç nga pesë lekë. Ata më pëlqenin shumë. Çdo muaj harxhoja vetëm dhjetë lekë.

Por një ditë, kur studioja në Akademinë e Arteve, pedagogia ruse, Nina, më bëri një vërejtje të rëndësishme:

- Nuk duhet të japësh lajmet. Kjo është në kundërshtim me mjeshtrërinë e aktorit dhe të folurisë skenike. Lajmi e thjeshtëzon diksionin.

Ajo kishte të drejtë. Një ditë kur u ktheva nga shkolla e gjeta mamanë në tavolinë. Kishte hapur albumin e vjetër të fotografive. E përqendruar me lapsin kopjativ në dorë diçka shkarraviste mbi një fotografi. U afrova akoma më pranë. Vura re se ajo shuante në fotografinë e martesës kapelën republikë që mbante në kokë. Ishte fotografi e bukur, e viteve 1930.

- Po, pse mama? Ky është kujtim i bukur.

- Jo, jo, sot nuk shkon.

- Po, pse?

- Sepse je e re dhe akoma nuk kupton asgjë.

- Kuptoj unë... Kuptoj... Por ne e kemi vilën bosh... jemi të varfër...

- Është më mirë kështu...

Eh! Atëherë ishin vitet e rënda të jetesës. Çdo gjë ishte me radhë, të gjithë ishim njësoj: visheshim, hanim, jetonim njësoj. Ishin vitet, kur rrugicat në dimër ishin të mbushura me llucë, kur mungonte ngrohja dhe reumatizma të gërryente kockat...

Kur fillova në Akademinë e Arteve interpretova role nga vepra të klasikëve. Por ajo që mbeti ishte drama “Ylli i Alpeve” e shkruar nga profesori dhe drejtori i Teatrit të Kukullave, Andon Pano. Me këtë dramë ne mbrojtëm diplomën. Secili personazh në këtë dramë personifikonte individualitetin origjinal të studentit. Më kujtohet gjithmonë profesor Andoni, i cili kishte një të folur të ngadaltë dhe me ëmbëlsi. Ishte një burrë zotni që të impononte shumë respekt.

Në këtë dramë unë kisha rolin e Qerosit. Ky personazh përfaqësonte mençurinë e popullit, dublantia ime ishte Edi Luarasi. E interpretova me shumë pasion dhe nivel të lartë artistik. Por ama, kujtesa ime më ngacmon për një njeri tepër special. Aktor, profesor, regjisor, Kujtim Spahivogli. Një djalë impulsiv, i mençur, i gjatë, me trup të formuar. Kishte një humor të këndshëm. Kur unë u fejova isha studente, dhe në klasë nuk i tregova asnjë njeriu se më vinte turp, ashtu ishte atëherë... Një ditë profesori, Kujtimi, sapo u fut në klasë e hodhi shikimin nga unë dhe, me një ton gjithë humor, shqiptoi:

- Hë, ore ju... - iu drejtua djemve. - Ku ishit? Flini... flini...
- e drejtoi dorën nga unë. - Iku kjo! U fejuar...

Klasa shpërtheu në të qeshura... Unë u skuqa, ula kokën dhe po mendoja: “Sa çudi! Ku e di profesori që unë jam fejuar? Nga e ka marrë vesh?”

Profesori ishte i dashur, na trajtonte si shokë, dhe ne të gjithë e donim shumë. Atë ditë profesori na bëri një bisedë

për filmat shqiptarë. Deri në atë vit ishin realizuar dy filma artistikë: “Debatiku” dhe “Toka Jonë”.

- Profesor! - iu drejtua Bernardi. - Na kanë thënë se në Kinostudio kanë ardhur regjisorë të rinj.

Profesori i interesuar shpjegoi:

- Ja, ja, po jua tregoj unë. Ju i keni parë filmat e parë shqiptarë që u realizuan në vendin tonë?...

- Po, po, - tha Bernardi, - “Debatiku”.

Mihoja shtoi:

- “Toka Jonë”.

Ne të gjithë lëvizëm nga bankat.

- Janë filma të bukur.

- E po, - tha profesori, - regjisor është Hysen Hakani. I ka mbaruar studimet në Çeki. Është serioz dhe shumë i përgatitur.

Pas një pauze, profesori vazhdoi:

- Në këto filma ishin dy djem të rinj operatorë: Viktor Gjika dhe Dhimitër Anagnosti.

Në klasë menjëherë u krijua një ilaritet. Filluam të lëviznim dhe ishim shumë kureshtarë të dinim për këta të dy. Profesor Kujtimi vazhdoi shpjegimin:

- Të dy këta djem kanë mbaruar “VGIK” në Moskë për operatorë. Janë shumë të përgatitur. Thuhet se së shpejti do të realizojnë që të dy një film të përbashkët në regji dhe në kamerë.

Aishja e interesuar ndërhyri:

- Po mirë, profesor Viktor Gjika mos është një djalë biond?

- Po.

- Sa i bukur!...

- Ehë! - tha Filika. - Dhimitri është akoma më i bukur. Vesh në dimër një pardesy ngjyrë qumështi.

Sakaq ndërhyri Aishja:

- Jo... atë pardesy e vesh Viktori...

- Jo, Dhimitri...

- Jo, Viktori...

Ndërkohë ndërhyri profesori:

- Pothuajse veshjen e kanë të ngjashme me njëri-tjetrin...

Filika e emocionuar, shtoi:

- Sa qejf kam t'i njoh nga afër...

Luigji shtoi:

- As mos u mundo, nuk ia rrëmben dot përshëndetjen
“Mirëmëngjesi!”.

- Uaaa!... Po pse kështu?

- E po, ja kështu e kanë...

U hodh Bernardi:

- Po ty ç'të duhet; pse kërkon t'i njohësh?!

Filika e ofenduar:

- Pse do të të marrë leje ty unë?!

Nga fundi i bankave u dëgjua nën zë Mario:

- Çiçibun... Bun... bun... Pllaq... plluq...

Bexheti i menduar, si për t'i mbajtur ison, plotësoi:

- *To be, or not to be...*

Profesor Kujtimi i pari shpërtheu në të qeshura dhe të gjithë ne u afruam te bankat e para, ja, ja... dukeshim sikur iu futëm në gjë...

- Profesor, - tha Luigji, - na trego për artistët rusë.

- Po, - tha profesori, - po iu tregoj për Tatiana Samojllovën.

Profesori nuk mbaronte, jo... e jo... vazhdonte tregonte... por edhe ne nuk mbaronim së pyeturi...

Por befaz, një ditë zëri i profesorit, aktorit, artistit, Kujtim Spahivogli, u zhduk si një mister... Nuk u dëgjua më. Ai nuk

u takua më me ne, nuk na tha dhe as na tregoi ndonjë fjalë. Ne u munduam shumë që ta kapnim atë “nuancën e zërit të tij” kërkuam që ta gjenim “parfumin e zërit të tij”. Dhe ne u “zemëruam” shumë me profesorin që u zhdruk si një legjendë, e kishim frikë që të pyesnim... Në heshtje dhe kokulur mallkuam: vitet e bolshevizmit rus, vitet kur shoku dhe shoqja shëtiste me ty, shkante në kinema dhe nga mbrapa të spiunonte, dhe përsëri përgjerohej për ty. Nga hekurat e kinemave shpërthente kolona zanore: Aljoshë, Natasha, Shura dhe Misha...

Ishin vitet e poetëve: Çernikovski e Eseninini këto ishin vite heroike dhe neve na dukej vetja se ishim kthyer në heronj...

Kjo ishte historia jonë!...

Nuk do ta harroj kurrë një ditë të bukur pranvere kur studioja në Akademi. Papritur përballë Teatrit takova pedagogen ruse, Nina Çefranova. Unë e dija shumë mirë gjuhën ruse. Në ato momente ishin prishur marrëdhëniet me Bashkimin Sovjetik dhe të gjithë rusët që punonin në vendin tonë duhet të largoheshin. Profesoresha e emocionuar më tha se do të nisej për në Moskë, dhe më pas me ëmbëlsi nuk harroi të më thoshte:

- Vajzë, je e talentuar. Të uroj që një ditë të jesh bërë artiste e madhe.

Unë qesha nën zë, kurse ajo më përqafoi dhe afër veshit më pëshpëriti:

- Dëgjo këtu do të të jap një porosi: më pak të talentuarit gjithmonë bëjnë përpjekje që ta ulin poshtë atë që është mbi të... Kujdes!... Zgjohu!

Më përqafoi edhe më puthi.

Unë u tremba, si e ngrirë qëndrova midis rrugës dhe në memorie m'u regjistrua porosia e saj: “Zgjohu!”.

Dhe nuk i harroj kurrë fjalët shumë të bukura të pedagoges sime, Nina Çefranova. Kur kryem studimet të gjithë prisnim emërimet në ankth. Ajo për mua ishte një ditë e shënuar. Na lajmëruan që të paraqiteshin në financë.

- Liri Brahimi, - lexoi shefi, - aktore në Teatrin Popullor dhe pedagoge në Akademinë e Arteve.

Sytë menjëherë nisën të më shkëlqenin nga gëzimi, dorën e vendosa te buzët që qeshnin dhe ngadalë fshiva pikën e lotit që rrëshqiste nga faqja.

Më dorëzuan dokumentin e emërimit dhe unë, e emocionuar, u largova. Sapo hapa derën u dëgjua një zë që më thirri:

- Liri, prit pak!

Menjëherë qëndrova. Në atë moment u afrua shefi, i cili e vendosi dorën mbi supin tim e thotë:

“Ku lë Larua të hajë Balua...”.

E çuditur po e shikoja dhe e çuditur pyeta:

- Çfarë?

- Një aktor më i vjetër sesa ti dhe me eksperiencë ka shfaqur mendimin se duhet të jetë ai pedagog...

Me çiltërsi vura buzën në gaz dhe plotësova:

- Shumë mirë, nuk kam asnjë pretendim. Jam e re...

Shefi i lumturuar më rrahu krahët.

- Urime! Punë të mbarë!

Dhe një ditë, u futa në një sallë të madhe të Teatrit Popullor. Në skenë bënin prova aktorët, kryeregjisori, Pandi Stillu, demonstronte tepër impulsiv dhe befas thirri:

- Stop!

Përfitova nga pauza dhe, me shpejtësi, u ula në rreshtin e parë të sallës. Aty mora vesh se po bëheshin provat e dramës

së Shilerit “Intrigë dhe dashuri”. Aty njoha trupën e teatrit. Artistë të talentuar që punonin me pasion në një skenë tepër të thjeshtë, dhe me një teknikë në nivel bashkëkohor.

Fillimisht kryeregjisori më aktivizoi në role të vogla episodike, si “Karnavalet e Korçës”, “Orët e Kremlinit”, “Katërmbëdhjetë vjeç dhëndër” etj. Kurse një ditë më komunikoi se në dramën “Doktor Aleksis” e Ibrahim Uruçit më kishte caktuar rolin kryesor, vajzën e doktorit, Lenën. Dhe unë nuk e zhgënjeva kryeregjisorin. Ai vazhdimisht më drejtonte komplimente, më thoshte se unë isha një aktore që përshtatesha në formë të shkëlqyer në skenë, se diksioni im transmetonte me vërtetësi dhe dramacitet mesazhin te spektatori etj.

Pas këtij roli erdhi në teatër një regjisor i dëgjuar kinez. Do të vinte në skenë me trupën e Teatrit Popullor dramën e dëgjuar “Muri i madh Kinez”. Ai bëri shumë prova derisa e plotësoi trupën që i duhej. Midis aktorëve që ai zgjodhi isha edhe unë. Më dha rol kryesor. Dublantia ime ishte Mimika Luca. Por nuk munda që ta përfundoja sepse papritur ndodhi diçka... diçka... që nuk më pëlqeu... që nuk e kisha menduar më përpara.

Dhe, nuk arrij dot që ta përshkruaj sesi m'u mblodh në grykë gjithë ai trishtim i menjëhershëm. Papritur doja të bërtisja, të qaja, të ulërija. Asnjëherë më përpara nuk e kisha ndier këtë padrejtësi! Kaq e fortë, padrejtësi që prekte ndjenjat dhe pasionet e mia - talentin. As nuk mundeni ta kuptoni sesi kjo të shkatërronte pak dhe nga pak... të gërryente dalëngadalë si dallga - shkëmbin. Të gërryente personalitetin, të zvogëlonte shumë-shumë... Ishte një vullkan që shpërtheu dhe tymi po më zinte frymën... Dhe kështu duhet të punoja në sektorin e regjisorës në Kinostudion “Shqipëria e Re”.

Ishte viti 1969. Do të paraqitesha për herë të parë në Kinostudio. Kur mbërrita te Monumenti i Ushtarit të Panjohur m'u kujtua që këtu dikur nga krahu i djathtë ishte *Kruga e Kusit*. E gjitha kjo rrugë ishte e mbushur me dyqane të vogla artizanale. Më kishte qëlluar që disa herë kisha ngrënë te qoftexhiu, Meti, qofte skare me pilaf. Akoma më duket edhe sot sikur e ndiej aromën e qofteve dhe pilafit të Metit. Kurse në qendër ishte vetëm xhamia dhe bashkia, kurse anash vazhdonin ministritë, universiteti, që ishin ndërtuar në periudhën e Viktor Emanuelit të III prej duarve të arta, nga mjeshtërit italianë. Por sot shumë gjëra ishin ndryshuar. Ishte ngritur Pallati i madh i Operës dhe Baletit ose Pallati i madh i Kulturës, si quhet rëndom, Monumenti i Skënderbeut, Muzeu Kombëtar etj. Kurse këtu në qendër gjithmonë qëndronte një polic, i cili në dorën e majtë mbante bilbilin, kurse me të djathtën drejtonte makinat. Por... pothuajse, sheshi gjithë ditën ishte bosh dhe ato pak makina që kalonin ishin të qeveritarëve. Aty në qendër përballë sahatit ishte Monumenti i Skënderbeut. Dhe, po të qëndroje përballë monumentit do të shikoje një rrugë të gjatë edhe të bukur që fillonte nga materniteti dhe përfundonte tek universiteti.

Momenti më i bukur i këtij bulevardi fillonte në orën 17:00 të darkës. Të rinjtë, vajza dhe djem pas mbaronte orari i punës ose edhe i shkollës, visheshin thjesht dhe mbushnin me gjallëri rinore bulevardin. Ky bulevard u bë gjithmonë edhe më i dashur për çiftet, ku linin takim për t'u prezantuar për herën e parë. Aty njerëzit shiheshin, përshëndeteshin, por ama edhe dashuroheshin. Menjëherë djali simpatik ia tërhiqte vëmendjen vajzës, derisa ajo dorëzohej. Ky bulevard i lidhte

tiranasi në ditët e bukura, por edhe në të shëmtuarat. Ishte e çuditshme. Bulevardi çdo natë ishte plot e përplot me njerëz. Zakonisht aso kohe njerëzit i kryenin punët në këmbë. Linja autobusi kishte pak. Kohëve të fundit kishin dalë në shitje edhe biçikleta, ato shiheshin tek-tuk... I hipa autobusit në qendër, në sheshin e Tiranës. Ishte hera e parë që po e bëja rrugën e Kinostudios. Kur zbrita në stacionin e fundit fytyrën ma rrahu një ajër shumë i freskët dhe m'u duk sikur mali i Dajtit ishte fare pranë meje... Hyra në oborrin e Kinostudios. Më rrëmbeu gjallëria, instinktivisht u futa edhe unë midis njerëzve të atjeshëm. U dëgjua një zë:

- Shpejt, shpejt, vendosni materialet elektrike sepse nuk ka kohë.

Që nga ajo ditë, ky do të ishte refreni i jetës sime këtu!

Erdhi me shpejtësi një *Gaz* dhe qëndroi përpara hyrjes. Nga korridori dolën dy veta me aparatura në duar edhe më pas një biond i gjatë, që e kishte hapin një metër. Ai mbante në dorë valixhen e kamerës. Duke fuguar u drejtua te dera. U dëgjua një zë nga brenda makinës:

- Dhimitër! Po operatori i zërit do të vijë?

- Sigurisht.

Ia ngula vështrimin dhe me vete mendova: "Uuuu! Po... po është ai, Dhimitër Lala".

Kamera është jeta e tij. Gjithmonë e rrëmben xhirimi dhe me pasion ngjitet nëpër pemë, nëpër ndërtesa, nëpër ballkone, por edhe nëpër mure. Nuk i intereson asgjë mjaft që të plotësojë atë që i duhet. Eh! Më kanë treguar për Kinostudion që punojnë njerëz të çuditshëm. Këtu çdo gjë lëvizka me ritëm. Nuk paska qetësi.

Unë u drejtova te porta e drejtorit dhe trokita.

Ndërkohë doli sekretarja, e cila më sugjeroi që të paraqitesha pas një ore. Përsëri dola në oborr, por këtë herë isha kureshtarë të shikoja nga mbrapa oborrit. Pashë repartin e transportit, ku njëra pas tjetrës dilnin makinat. Bahçja ishte e mbushur me ullinj. Dëgjohej zhurma e sharrës, goditjet me çekiç dhe më poshtë punëtorët po ndërtonin një dekor të thjeshtë për xhirimin e një filmi, dëgjohej që nga lart një zë që bërtiste:

- Hiqi dërrasat që janë poshtë sepse pengojnë!

Dy punëtorë i tërhiqnin zvarrë me shpejtësi. Po ecja e çuditur duke thënë me vete: “Këtu paska punë edhe jo shaka”. Në meditim e sipër vura re se në fund të bahçes ishte një klub i vogël. Uh! Sa mirë po hyj të pi një kafe dhe kështu shtyj edhe kohën.

Po ngjisja një palë shkallë të vjetra çimentoja që të çonin te bufeja. Kokën e mbajta poshtë se mos rrëzohesha. Por papritur aty ku kisha vendosur këmbën pashë një dhjetëlekëshë. U përkula ta merrja dhe të mos e shkelja me këpucë. E dini se çfarë shkelja me këpucë. Por papritur... E dini se çfarë ndodhi? E çuditshme: si me magji dhjetëlekëshja nisi të ecte... Dora më ngeli në hava, e drejtova trupin dhe e çuditur po shikoja rrugën, që po bënte dhjetëlekëshja. Në moment ia ngula edhe njëherë vështrimin mirë. Uaa! E kishin lidhur me një fije peri tepër të hollë që nuk dukej fare.

Papritur u dëgjua një zë i mbytur poshtë shkallës që bërtiti:

- Pse deshe ta vidhje?... Ha-ha-ha...

M'u mblodh një si lëmsh në grykë. Dikush po më tallte... U tremba... Ngurova të futem në bufë. Por papritur u dëgjua zëri i bufetierit:

- Hajde, shoqe, hajde! Ai bën shaka...

Duke u dridhur u futa brenda dhe bufetieri vazhdoi:

- Është elektrikisti, Fiqiri Cara. Ky është humori i tij... Është një djalë shumë i mirë, aty qan... edhe aty qesh... E kupton?

- Po... po... Të lutem më jep një kafel!

Pasi e piva kafen, në orën e caktuar gjendesha para portës së drejtorit. Drejtor ishte Vaskë Aristidhi. Babai i tij ishte veteran i kinemasë në Korçë. E donin të gjithë në Kinostudio për karakterin e tij të butë, për atë gojën e ëmbël dhe për paraqitjen e tij gjithë nur dhe lezet; kishte fituar simpatinë e respektin e të gjithëve.

Trokita në derë.

- Urdhëro, - u dëgjua nga brenda zëri.

Sapo e hapa derën pashë një portret të ngrohtë që përsëriti:

- Urdhëro... urdhëro ulu!...

Menjëherë u çlirova nga streset dhe zura vend në karrige.

- Ju faleminderit!

- Je, Liri Brahimi?

- Po.

Midis të tjerave, drejtori theksoi:

- Do të filloni punë në sektorin e regjiturës. Si fillim as/regjisore. Fillimisht, për t'u njohur me profilin e filmit, do të punoni në sektorin e kronikave.

Ia ngula shikimin dhe e dëgjova me vëmendje. Më poshtë drejtori vazhdoi:

- Më vonë do të punosh as/regjisore me filmat artistikë. Do të shkosh gjithmonë me shërbime jashtë Tiranës. Do të punosh vetëm me meshkuj, prandaj, kujdes!

Unë lëviza nga karrigia edhe vura buzën në gaz. Drejtori duke më parë direkt:

- Jo... me gjithë mend... Pastaj ne “djemkat” i kemi edhe të bukur. Prandaj kujdes! Mund të të bien në qafë...

Unë e çuditur po dëgjoja edhe më poshtë nxora një pasthirmë:

- Uaa!

Sa me ëmbëlsi fliste, sa njeri i mirë, sa i butë, në moment m’u duk si babai im... Drejtori më zgjati dorën duke më theksuar:

Urime! Punë të mbarë!

E emocionuar u paraqita në zyrën e kronikave dhe të dokumentarit. Në korridorin e madh dhe në zyra kishte lëvizje të madhe. Hynin dhe dilnin krijues: regjisorë, operatorë, piktorë etj. etj. Përballë në tavolinë qëndronte shefi - Peçi Dado. Kisha respekt, emrin ia kisha dëgjuar në filmin e regjisorit Gëzim Erebara “Në fillim të verës”, Peçi Dado ishte skenarist, madje ky ishte skenari më i bukur i tij. Kur ia ngula vështrimin m’u duk pak melankolik. Filluan të mblidhen krijuesit për apelin. Hyri me shpejtësi Endri Keko regjisor, i cili është cilësuar si një nga themeluesit e filmit dokumentar dhe kronikal. Endri me një frymë iu drejtua Peçit:

- Të lutem do t’i mbushësh operatorit urgjent fletëshërbimi sepse planet në trikotazh në Korçë kanë dalë “sfokato”!

Peçi i revoltuar iu kthye Endrit:

- Kush i paguan gjithë këta metra film “Kodak” me ngjyra, ti vë unë nga xhepi?

- Aaa! Për këtë unë nuk kam faj!

Peçi i hodhi një shikim Pashkos:

- Duhet të jesh i kujdesshëm!

Pashko që nuk kishte faj shpjegoi situatën:

- Nuk është faji im... Objektivi 18 duhet kontrolluar te Tomi, se ka defekt...

Peçi u ngrit nga karrigia.

- Hajde, hajde sistemoni gjërat, nuk pret koha, duhet brenda javës kinoditari të hidhet në prodhim.

Endri dhe Pashko me shpejtësi dolën nga zyra. Menjëherë u duk te dera Hamdi Ferhati, pioneri i filmave dokumentarë dhe kronikalë. Duke qeshur raportoi:

- Nesër e kam gati filmin “Reportazh nga Mirdita”.

- Shumë mirë, po afishoj shpalljen.

U mbloodhën krijuesit gjysmë ore e i ndanë dhe i përcaktuan detyrat. Isha aq shumë e hutuar dhe akoma nuk po kuptoja se çfarë bëhej. Në moment m’u duk si ajo kosherja e bletëve, që vazhdimisht gumëzhin dhe pa pushim prodhon mjaltin. Këtu ishte tamam një kombinat prodhimi. Unë duke ulur sytë poshtë shikoja me vëmendje dhe kërshtëri këta regjisorë dhe operatorë, që diskutonin me pasion. Çudi! Disa prej tyre kishin qenë pjesëtarë të luftës Nacional Çlirimtare dhe oficerë. Sa bukur tingëllojnë këto! Endri Keko kishte luftuar në mal, dhe bashkë me pushkën ai kishte mbajtur edhe kitarën. Kurse Agim Fortuzi kishte qenë korrier partizan. Ua, me sa dashuri e shtrëngon kamerën! Me qëndrimin e tij ai duket sikur thotë:

- Është kamera ime... Më takon vetëm mua...

Por veterani Sokrat Musha, edhe ky pjesëtar i brigadave partizane, i afrohet ngadalë:

- Avash... Agim, jemi edhe ne!

Kurse regjisorja Marianthi Qemo me gishtin tregues:

- Jam edhe unë! Mos harroni!

U bënë dëshmitarë edhe muret që gjëmuan nga krijuesit.

- Edhe unë... Jam unë... Mos harro...

Të gjithë këta kishin kryer shkollën dhe kurse kualifikimi për kinematografinë në Bashkimin Sovjetik. Secili kishte

individualitetin e të veçantën e tij në realizimin e kinoditarëve dhe dokumentarëve. Por ajo që është kryesorja ishin që të gjithë të pasionuar dhe punonin me përkushtim. Megjithatë gjithmonë korniza ishte Realizmi Socialist.

Eh! Që të kujtosh ato vite të duket drita pak e zbehtë si ai vaji i trashë në ngjyrë pak të verdhë, që mezi rrëshqet me mundim dhe ngadalë... Kurse unë po mundohem që t'i sjell, t'i rikthej të pastra, për ta ringjallur atë krijimtari plot vuajtje edhe sakrifica. Herën e parë që u futa në sallën e krijuesve atë ditë do të shfaqeshin dy filma dokumentarë:

“Reportazh nga Mirdita”, realizues ishte Hamdi Ferhati dhe: “Vëllezërit Tare” realizues Endri Keko.

Zakonisht në sallë nuk kishte shumë krijues, dhe diskutimet nuk ishin të gjata. Kisha zënë vend në rreshtin e parë edhe prisja... Hynin dhe dilnin dy operatorë zëri energjikë, që kontrollonin aparaturat e dëgjimit: Asim Raxhimi dhe Xhevat Behri. Të shqetësuar, me shpejtësi, në kohë rekord hynin në sallë te aparaturat e zërit, kontrollonin dhe përsëri dilnin. Unë emrat e tyre i dija përmendësh, nuk numëroheshin rastet se në sa dokumentarë dhe kinoditarë i kisha lexuar, dhe ja, tani po i njihja dhe nga fytyra. Krijuesve të këtij sektori e gjithë dita u shkante duke vrapuar, sepse dhe vetë temat nuk kishin mbarim: Inaugurimet... Vizitat e udhëheqjes... Kongreset... Tërmetet... Bllokimi nga dëborat etj...

Në ato vite nuk ishte e domosdoshme që të kishte gjithmonë skenarist sepse regjisor, që realizonte dokumentarin shumicën e rasteve ia bënte vetë edhe tekstin. Si p.sh. Endri Keko e të tjerë. Disa prej tyre bënë regjinë dhe kamerën. Pra, në ato vite shikohej në plan të parë prodhimtaria e mbaruar në

kohë rekord. U fut në sallë shefi i redaksisë, dramaturgu dhe skenaristi Peçi Dado.

Filloi shfaqja e filmave. Kur mbaroi shfaqja unë kisha ngrirë në sallë dhe po mendoja: “Është akoma shpejt për mua që të diskutoj, sepse akoma nuk e njoh filmin dhe regjinë e tij. Por, kuptova një gjë - në gjithë këtë ngarkesë prodhimi, nuk priste koha për të menduar për krijimtari artistike - në këta dy filma e veçanta e tyre qëndronte në atë që kamera dhe montazhi nuk e linin filmin që të zvarritej... Po konstrukti dramaturgjik, do të pyesni ju, të linte për të dëshiruar? Po pse?”. Sepse në momentin më të bukur që mundet të krijohet, regjisori e thjeshtëzonte emocionin, i fuste një tekst shumë “të fortë”. Sepse ashtu duhej...

Është tepër e çuditshme e gjithë kjo. Këta krijues të nderuar që vinin nga vitet e zjarra patjetër do të pasqyronin në filmat e tyre atë që kishin ndier si pjesëtarë të armatës të revolucionit. Dhe tani ky revolucion duhej të thellohej në filmat tanë. Pra filmat tanë të parë u realizuan në prehrin e këtyre transformimeve revolucionare, prandaj dhe filmi duhej të forcohej në ide dhe përmbajtje. Kuptova drejt atë fakt që të tipizoje portretin e një heroi ose edhe të një figure pozitive kjo gjithmonë duhet të kishte në qendër partishmërinë proletare. Kjo figurë duhet të ishte e vendosur në baza të sakta ideologjike dhe politike. Ndryshe shmangia e kësaj pike të largonte nga jeta. Prandaj i vura kushte vetes që nga kjo pikë nuk do të largohem. Por nga ana tjetër nuk do të pranoja kurrë që të realizoja një dokumentar ku mbizotëron toni euforik. Dhe nuk do të pranoja kurrë që të xhiroja në një zbrazëti, si të drejtoheshe në një zyrë kuadri dhe të kërkoja biografinë e X personi: emri... mbiemri... datëlindja etj.

Ja, kjo nuk ishte krijimtari në vetvete. Kjo ishte një faqe gazete. Prandaj po e shtrydhja mirë trurin që në çdo skenar që do të merrja duhet patjetër të gjeja të veçantën në mënyrën e trajtimit nga ana artistike.

Kërkova në redaksi një skenar filmi dokumentar, në momentin që akoma nuk isha e angazhuar me filma artistikë. Shefi, Peçi Dado, nisi të kontrollojë në dosjen e skenarëve dhe si përfundim, madje edhe si në mëdyshje, më zgjati një skenar të një bashkëpunëtori të jashtëm.

- Ja, tani për tani është ky skenar.

U gëzova, më shkëlqyen sytë dhe u afrova. Peçi duke vënë buzën në gaz shqiptoi: “Monumentet e Natyrës”.

- Pasi ta studiosh, duhet të nisesh me shërbim që të verifikosh çdo gjë në mënyrë konkrete.

U largova nga zyra shumë e gëzuar. Pa ekzagjerim nuk fjeta gjithë natën. E lexoja, e stërlexoja... Kërkoja të gjeja boshtin. Jo, nuk kishte bosht... Atëherë vrisja mendjen se mbi çfarë ideje do të varej ky skenar, i cili kishte edhe titull të bukur “Monumentet e natyrës”.

Nuk kishte asnjë histori të veçantë të këtyre monumenteve... Çfarë kishte ndodhur me evoluimin e kohës. Skenaristi duhet të mblidhte sa më shumë materiale jetësore. Dhe kjo kërkonte punë këmbëngulëse, intensive, që më pas të sugjeron për ndërtimin e filmit të ri, madje kjo do të ketë edhe të veçantën e tij. Por skenaristi për ta mbushur boshllëkun e tij kishte përdorur në skenar inskenimet. Kjo është rruga më e shkurtër në film. Filmi gjithmonë kërkon mjete të reja që të ketë të veçantën dhe individualitetin e vet. Pra, kjo ishte një njohje kalimtare e temës dhe pikërisht kjo pengonte për të krijuar një konstrukt të qartë dramaturgjik.

Me këtë film nuk e gjeta veten time plotësisht. Kisha shumë kërkesa në vetvete sepse shkolla, talenti, nuk më mungonin. Kur u shfaq filmi në kolektivin krijues operatori Hamdi Ferhati theksoi:

- Pse moj bijë i ke rrotulluar lisat dhe bredhat? Pse nuk i ke lënë të qetë në vendin tyre?... Çudi! - ofshau operatori veteran.

Por edhe unë ofshava me vete: “Çudi!”.

Më detyruan të hiqja planet më të bukura... Atë ditë kur fill pas shfaqjes së filmit dola në oborr, aty m’u afrua ngadalë një burrë rreth të pesëdhjetave. Ishte simpatik me sy bojë qielli, kishte veshur një xhakëtë astragan, ngjyrë gri me cirka të bardha. Më zgjati dorën.

- Hysen Hakani...

Në moment më hipi një e skuqur në fytyrë. M’u kujtuan filmat e tij që më kishin pëlqyer shumë, prandaj e gëzuar... e emocionuar nxora pasthirrmat:

- Uuu!... Po... po...

Dhe i zgjata dorën.

- Liri Brahimi...

Hyseni me shumë gjallëri më tha:

- Si të duket puna këtu?

- Shumë bukur!

- Eh... ka punë, ka shërbime!

- E di... e di...

- Por gjithë këto vitamina që hamë çdo ditë; mish, zarzavate, fruta na japin energji që t’i përballojmë gjithë këto sakrificat...

Në moment u tremba, ktheva kokën majtas dhe djathtas, nuk kishte njeri. Atëherë mbyturazi qesha aq shumë sa më dolën jargë nga goja, kurse Hyseni menjëherë ndërhyri:

- Nuk ka gajle mi gocë, fshiji qurrat me mëngën e trikos.

Atëherë shpërtheva edhe më shumë në të qeshura. Hyseni mori një qëndrim serioz dhe m'u afrova:

- Ndigjo këtu: këto ditë filloj të xhiroj një film artistik. A je dakord të vish me mua as/regjisore?

Menjëherë qesha dhe u gëzova.

- As mos e diskuto.

Hyseni u gjallërua:

- Ndigjo këtu! Mos fol me asnjë derisa ta komunikojë drejtoria...

- Dakord. Si quhet filmi?

- "Ndërgjegjja".

Hyseni u largua kurse unë shumë e gëzuar po mendoja që nga ky regjisor do të mësoja shumë. Nuk e harroj kurrë ambientin ku u shkrua skenari tekniko-regjisorial. Ishte kati i dytë i Pallatit të madh të Kulturës. Pallati ishte i ri i bukur, me ambiente frymëzuese. U shkrua me pasion dhe profesionalizëm. Saim Kokona ishte operator. Edhe Saimi i kishte kryer studimet së bashku me Hysenin në fakultetin Kinematografik Famlí-Pragë. Kështu që Hyseni ishte i shkrirë me Saimin "në njësh" në kuptimin artistik. Ky skenar po shkruhej me një ton modernizimi dhe mendimi të ri.

E ndjeva veten shumë mirë sepse Hyseni respektoi mendimet e mia në shkrimin e skenarit. Akoma edhe më shumë mësova gjëra dhe gjetje të reja nga sheshi i xhirimit. Regjisori dhe operatori e ngrinin akoma më lart skenarin në xhirim duke futur detaje të reja. Saimi përdori me art karelën rrethore, me finesë dhe elegancë transfokatorin etj. Më kujtohet një ditë te sheshi i xhirimit po bënim pushim, me kujdes u afrova te Saimi dhe e pyeta për objektivat:

- Të lutem Saim, çfarë funksioni kryen objektivi 9.8?

Ai nuk përtoi, menjëherë u afrua dhe nisi të më shpjegojë funksionimin e disa objektivave. Dhe a e dini se çfarë bëja? Çdo ditë kur bëhej pushim gjatë xhirimit e ndiqja Saimin me vështrim dhe më pas e pyesja për kamerën dhe objektivat. Ai asnjëherë nuk u mërzit, kurse unë mësova shumë nga ai. Kurse një ditë i thashë kështu:

- Saim! Periudhën që unë nuk do të jem e angazhuar me filmin artistik kam të drejtë që të xhiroj një film dokumentar.

- Po, po e di këtë rregull...

- Atëherë në qoftë se më bie në dorë një skenar i mirë unë kam dëshirë që ta xhiroj me ty.

Menjëherë ia lexova në sy mendimin që ishte dakord.

- Mos e diskuto! Kur të duash unë jam gati...

Oh! Sa shumë u gëzoja! Do të thoni ju, pse? Ja, pikërisht për atë që unë e shikoja filmin dokumentar në sensin artistik, sepse doja me çdo kusht të fusja elementin artistik. Për këtë vuaja shpirtërisht.

Me profesionalizëm dhe ndjenjë artistike duke dhënë hije dhe dritë, Saim Kokona e kishte veshur mirë rrobën e kompozimit artistik të kuadrit. Dhe talenti i Saimit i kishte arritur nivelet, duke përdorur me art dhe në funksion të dramaturgjisë së filmit. Suksesi i një filmi fillon qysh në skenarin tekniko-regjisorial. Ai duhet të bëhet burim frymëzimi për grupin realizues. Dhe më pas grupi duke punuar me pasion e këmbëngulje i ngre edhe më lart vlerat kinematografike.

Pra, në filmin “Ndërgjegjja” mjeshtëria e Hysenit, e Saimit dhe e të gjithë grupit të filmit bëri që filmi të kapte nivelet e duhura. Por nuk arrij dot që ta përshkruaj gëzimin e asaj dite, të asaj ore, që kurrë në jetën time nuk e kisha provuar një ndjenjë kaq të bukur... Do të pyesni ju se çfarë?...

Ja... Ja... juve ju kujtohet të gjithëve kur oborri i Kinostudios u mbush plot me skenaristët e rinj që sapo dolën nga bankat e universitetit... Menjëherë nisën punën si skenaristë në dy redaksi, të Artistikut dhe të Dokumentarit. Ishin djem dhe vajza të talentuara që me pasion filluan të krijojnë: Natasha Lako, Nexhati Tafa, Luan Rama, Angjelina Xhara, Kolec Traboini, Ilia Dede, Bashkim Hoxha e Kliton Gilani, Kujtim Gjonaj e Halil Kamberi, Petrit Ruka, Vllasova Musta, Dolores Sinica etj. Të gjithë këta skenaristë u mbuluan mirë së bashku me skenaristët, dramaturgët dhe shkrimtarët: Vath Koreshi, Teodor Laço, Kiço Blushi, Peçi Dado etj. Kështu nisi një epokë e re në Kinostudio, erdhën edhe studentë nga Akademia e Arteve në degën e Regjisurës: Rikard Laria, Saimir Kumbaro, Kristaq Mitro, Ibrahim Muça, Liri Brahimi, Mark Topallaj, Ismahil Zhabiaku, Xhezair Dafa, Qerim Mata, Petrit Llanaj etj. Dhe ne të gjithë u sistemuan pranë regjisorëve që kishin mbaruar studimet jashtë: Viktor Gjika dhe Dhimitër Anagnosti, Gëzim Erebara e Kristaq Dhamo, Hysen Hakani e Piro Milkani etj. etj. Dhe na pritën me çiltërsi, na zgjatën dorën me dhembshuri, secilit na ofruan zemrën e ngrohtë. Ishte producenti, regjisori dhe nëndrejtori Todi Bozo, Vangjush Zallëmi, Vaskë Aristidhi e Viktor Gjika etj. të cilët na ofruan karrigen për t'u mbështetur, na ofruan veshin për të na dëgjuar me vëmendje, dhe ne i pamë drejt edhe në sy, me zemër të pastër.

Dhe, sa bukur ishin ata studentë dhe studente, që sapo dolën nga bankat e universitetit sollën një frymë të re plot optimizëm e energji të reja krijuese. Ishin ata studentë, që sollën në filmat tanë ndjenja të freskëta, secili solli individualitetin, veçoritë personale të tij.

Kështu nisën të shpalosen filmat e rinj me “gjetje të bukura dhe mjete shprehëse të reja”. Nisi një përpjekje e re e skenaristëve, edhe pse të rinj në moshë ata e kapën periudhën e kaluar dhe të sotshmen duke pasur arritje të suksesshme. Folën qartë me zërin e me ndjenjat e tyre. Këta nuk ishin vetëm skenaristë, por edhe poetë e dramaturgë. Këta i pushtuan të gjitha sferat. Nuk e harroj sesi nisi të gumëzhijë redaksia e dokumentarit nga diskutimet e krijuesve të shkruara me pasion nga të gjitha temat: shkencore; artistike; mjekësi etj. Për ne regjisorët, skenaristët ishin në krye të krijimtarisë. Vazhdimisht fugonim pas tyre, sepse nga ata frymëzoheshim dhe hapnim një dritare të re, për këtë ne i admironim që të gjithë. Midis nesh kishte shokë që mbronin me devotshmëri idetë socialiste, madje asnjë ditë nuk iu shpëtonte pa lexuar gazetën “Zëri i Popullit” e kështu me radhë. Megjithatë e gjithë qenia jonë ishte drejt së ardhmes, sepse e kaluara ishte gjithë halle. U kthyen në tolstojanë e dostojevskë, në poetë, dramaturgë e publicistë. Dhe ja të gjithë këta të rinj e kthyen redaksinë në diskutime artistike. Dhe mendoja: “Atëherë, sa të gatshëm dhe optimistë që janë për ta reformuar kinematografinë?”. Këta krijues ishin të gatshëm të pasqyronin, romantizmin, dashuritë e dështuara, dashurinë e artistit midis mijëra abazhurëve, një shëtitje me gondola në Venecia apo një ngjitje në kullën Eifel... Çfarë po flas kështu?! Unë harrova se këto nuk të linte njeri as t’i mendoje dhe jo më t’i shkruaje a xhiroje... Mos e dhëntë Zoti!

Këto ndodhnin diku larg, jashtë kufirit tonë. E, mbarë bota, në përgjithësi, ishte larg nga ne, ose jo... jo... ne ishim larg nga bota. Ne ishim një racë e mbarsur me heroizëm dhe me egon udhëheqësore për të zënë gjithnjë vendet e para në

renditjet globale, si vendi i parë ateist etj. për çka na kishte zili e gjithë bota. Edhe se ishim një vend i vogël dhe i pazhvilluar, por ama si popull ishim të edukuar dhe jo budallenj. Nuk ishim popull që të na trajtonin si bagëti, që të na vinin përpara me shkop!...

Dhe ja, në krye mbi të gjithë, qëndronte larg ndërtesës së Kinostudios andej poshtë nga qendra e Tiranës një ndërtesë e madhe interesante. Aty zhvillohej, diskutohej e vendosej fati i të gjithëve. Andej vinin lajmet e mira edhe të liga... andej drejtohej zhvillimi i artit dhe i kulturës. Dhe për secilin çdo ditë dërgohej edhe pika edhe presja për krijimtarinë e tyre. Çudi! Se çfarë kishte ajo ndërtesë një si biçim “magjie të veçantë”. Dhe, njerëzit flisnin me admirim për drejtuesit, për idetë e tyre që po çudisnin botën.

“O sot... o kurrë, kërkohen filma me partishmëri dhe që krijuesi të fiksohej në atë botëkuptim, në ato zakone, ato shije dhe ndjenja, që të mos lejojë ringjalljen e botëkuptimeve mikroborgjeze. Që sot më shumë se kurrë të zbatohet principi, që arti ynë të përshkohet nga parimi i partishmërisë proletare duke u mbështetur në metodën e Realizmit Socialist...”.

Kjo ishte historia jonë!

Pasi mbaroi filmi “Ndërgjegjja” isha në kërkim të një skenari për të xhiruar një film dokumentar. Sapo vinim në mëngjes në Kinostudio ishim në kërkim të një qosheje të ngrohtë, që të hanim mëngjesin. Çudi, djemtë asnjëherë nuk e hanin mëngjesin aty!... Ne e theknim bukën e zezë duke e shoqëruar me pak djathë ose edhe gjizë. Hallet tona nuk kishin marr fund. Ishin vitet e bllokadës së egër, e cila quhej borgjezo-revizioniste. Sa të dobët që ishim fizikisht. Vështirë të gjeje njeri me bark... jo... jo, madje na numëroheshin edhe brinjët. Një ditë pamë një film

të Hollivudit. Ishte një episod, ku familjarët po hanin drekën. Ne të përlotur po numëronim pjatat: e para... e dyta... të tjerë u gëlltitën... Ishim të varfër... Dhe nuk ndiheshim... Përballonim lodhjet nëpër male me shi edhe dëborë, po ne ishim të gjithë heronj-artistë me shumë halle...

Atë ditë në mëngjes unë vendosa të blija në klub një panine dhe një qofte. Ky ishte luks. Afër meje ishte shoferi i grupit tonë. Ai kishte blerë një shishe arançatë të vogël dhe po e pinte. Nisëm të bënim muhabet bashkë. Shoferi po e shijonte arançatën dhe prandaj po e pinte me gllënjka shumë të vogla. Kur papritur te dera e bufesë hyri një nuse e re me fëmijën në krahë. Kishte një fytyrë të zbehtë dhe e ngashëryer, hoqi në zemër. Fëmija ia kishte vendosur kokën te supi dhe thithte një gisht në gojë. Sapo e pashë u çudita m'u duk se e njihja, se diku e kisha parë... Fytyra e gruas tregonte diçka të largët...

Menjëherë shoferi lëshoi një ofshamë, lëshoi shishen e arançatës mbi banak dhe i doli gruas përpara, i mori fëmijën që po e përkëdhelte. Gruaja u drejtua nga unë:

- Je, Liri Brahimi?...

- Kush jeni ju?

- E mban mend aksionin e hekurudhës në Librazhd?

Sytë sikur më dolën nga zgavrat. U çudita! Ajo ishte Eva. Atëherë ishte tetëmbëdhjetë vjeçe dhe unë nuk e kisha parë më. Në atë kohë Eva ishte femër shumë e bukur. Dhe nuk harrohen kurrë ditët në hekurudhë, ne flinim bashkë në një krevat dysh. Më kujtohet që mami i kishte qepur një fund kloshe me trëndafila të kuq, sepse atëherë veshja ishte shumë e dobët. Kur ne mblidheshim në kapanon, Eva niste rrotullimin duke demonstruar trupin e bukur dhe bërtiste me sa forcë që kishte: “Unë do ta marr burrin doktor!”.

Të gjitha shpërthenim në të qeshura dhe nuk mbaronim kurrë... Ishte shumë e gjallë... Sa shumë ka ndryshuar, nuk e njoha fare!... Do të pyesni ju se pse e donte burrin doktor? Sepse në ato vite qarkullonte fjala që vetëm doktorët marrin shumë pará!

Shoferi, Astriti e pyeti Evën:

- Çfarë të tha doktori për vajzën?...

Eva e shqetësuar shpjegoi që vajza kishte bronkit. Doktori tha se duhet të pijë: lëng mishi dhe lëngje frutash...

- Por mos harro, më porositi që çdo ditë duhet të pijë qumësht!

Astriti kapi kokën me dorë:

- Obooboo! Si do t'ia bëjmë?

Unë ula kokën dhe psherëtiva... E dija mirë se çdo të thoshte kjo: mishi nuk gjendej, frutat jo e jo, qumështi ishte me radhë. Dhe këta ishin punëtorë me rroga të ulëta.

Shoferi i përlotur i afroi gruas shishen e arançatës së tij, por unë në moment u porosita arançata dhe panine me qofte. Sa shumë u gëzuan. Dhe, për t'u larguar mërztitjen u premtova se:

- Ja, tani do të shkojmë në shërbim nga veriu, dhe do të përpiqemi se mos gjejmë mish në ndonjë kooperativë bujqësore.

Eva u rrëmbush gati për të qarë dhe më mori në qafë.

- Faleminderit, gjithmonë vetëm mirë ke bërë!...

Sa shumë u gëzua! Eh! Si është jeta! Ja, se si u takuam prapë. Por Eva ishte kthyer në një grua e brengosur, por megjithatë krenare. Shoqëria në grupet e filmave ishte tepër e çuditshme. Ishte tamam si një rreth që të gjithë rrinë bashkë. Ua dinë të mirat dhe të metat, ndiejnë dhembshuri dhe dashuri si në

një familje. Eh, por në jetë gjithmonë ka batica dhe zbatice... Kjo është historia jonë... Dhe ja, një ditë papritur duke gërmuar në redaksinë e dokumentarit gjeta një skenar që titullohej “Galeria e Arteve”. E kishte shkruar një skenariste e re, Vllasova Musta. Po ta shikoje në planin e përgjithshëm Vllasova ishte pak melankolike, gjithmonë serioze, shumë e heshtur, pothuajse nuk fliste fare. Por ama, përbrenda ajo që një vullkan. Ishte poete dhe tani skenariste. Pra ishte me shije artistike, por mbi të gjitha ishte një vajzë e zgjuar. Vllasova e kishte shkruar me kujdes skenarin, duke dhënë me një tablo të qartë dhe realizëm veprat e piktorëve dhe skulptorëve më të mirë të vendit tonë, që ishin ekspozuar në Galerinë e Arteve. Fillimisht, kur studiova skenarin doja patjetër të fusja diçka më shumë, ta ngrija më lart atë që ishte shkruar dhe ta ktheja njëqind për qind në skenar filmik. Por ama, unë po përpiqesha të fusja diçka më tepër nga ato që pashë në sallën e krijuesve. Doja të fusja elementin artistik. Në vija të trasha në këtë skenar ishte mishëruar dhe shpalosur ideja, puna krijuese e këtyre artistëve: piktorë, skulptorë duke nënvizuar “burrërinë, guximin, qëndrueshmërinë në shekuj të popullit tonë”. Dhe, përbrenda veprës kishte mishëruar: ndjenjën, stilin, notën epike. Nuk mungoi edhe ndjenja - nota lirike. Me vëmendje edhe me pasion së bashku me operatorin Pëllumb Kallfa zbërthyem mirë skenarin tekniko-regjisorial, futëm si element shkrirjet, u përdor me kujdes transfokatori. U përpoqa që të sigurohej një zgjidhje e drejtë midis komponentëve: tekstit, muzikës dhe figurës. Edhe teksti nuk ishte thjesht ilustrues i figurës, por e vendosa drejt në mënyrë profesionale dhe në harmoni me muzikën. Pra, këta komponentë ishin të harmonizuara dhe të ngjallnin emocion. Futa vizitorët në

galeri, të cilët ishin boshti që lidhnin pikturën me vizitorin. Fantazia dhe pasioni punoi mirë në funksion të idesë së filmit. Atë ditë që filmi u shfaq në Kinostudio në sallë u prit mirë. Drejtori Vangjush Zallëmi lëvizi nga karrigia sepse unë isha ulur mbrapa tij dhe më dha zemër:

- Ja, kështu... je mirë... po ecën mirë!...

Unë u emocionova shumë edhe nga diskutimet e shokëve, të cilat u bënë në sallën e krijuesve. Kështu fantazia dhe pasioni u tretën mirë në funksion të idesë së filmit. Filloi një refren i pandalshëm për mua; valixhja rrinte gati! Ora me zile ishte gati... Nga filmi artistik... në atë dokumentar... anasjelltas... Refren pa fund... refren i çuditshëm e i përditshëm, që nuk më lodhi asnjëherë! Pothuajse isha ndarë nga njerëzit e mi të afërm, nga vizitat, nga shëtitjet me familjen dhe mbi të gjitha për rritjen e dy vajzave, ishte angazhuar burri dhe prindërit e mi. Isha kthyer si një robot që vetëm punoja dhe krijoja me filmat. Çfarë sakrificash!...

Dhjetë vjet nuk bëra asnjëherë leje të zakonshme, çka ndoshta pak kush do ta besonte atëherë, po dhe sot! Dhe së fundi, mora titullin: regjisore filmi.

Pantallonat nuk hiqeshin nga trupi, kapela nga koka dhe këpucët me qafa... Po a e dini ju se ato vite heroike ishin: më të bukurat, më të ndershmet, më të sinqertat!

Ishin vitet e shpërthimit të talenteve pa kufi... Do të thoni ju ishin vitet e varfërisë? Po, po... si duket këto ishin kushtet më të përshtatshme për të shpërthyer në art - kulturë - shkencë. Këto ishin vitet kur arti kërkonte të shikonte sa më larg, kërkonte të çlirohej nga zinxhirët e realitetit të vrazhdë, duke operuar me të bukurën, me atë që frymëzonte...

Një ditë në mëngjes kur u ktheva nga shërbimi bashkë me grupin e xhirimit qëndruam në oborrin e Kinostudios për të lënë aparatet e xhirimit. Sapo zbrita nga makina gjëja e parë që bëra e shtriu trupin, që më kishte ngrirë duke udhëtuar gjithë natën. Çudi! Në oborr kishte rënë një heshtje varri... Nuk kishte asnjë lëvizje!

Çfarë ka ndodhur? - tha Leko Ziaudini i çuditur. - Nuk u dëgjua as miza...

Me qetësi u futëm në korridor. Heshtje! U drejtua për nga salla e madhe e krijesve. Salla ishte plot. Drita ishte fikur. Dëgjohej vetëm frymëmarrja e krijesve që në heshtje e kishin ngulur vështrimin nga ekrani që edhe ai ishte në heshtje... Ngadalë u afrova te veshi i një shoku:

- Çfarë ka?

- Shëëët...

- Po, pse?

Shoku duke shfryrë me grimasa në fytyrë dhe lëvizje duarsh theksoi:

- Tani fillon filmi i Dhimitër Anagnostit “Lulëkuqet mbi mure”.

- Uaaa!... - thashë unë.

Sa shumë u gëzova, kisha kohë që e prisja. U afrova te shokët, që të ngrirë rrinin në këmbë:

- Shpejt, shpejt me qetësi të sigurojmë ndonjë karrige!

Isha me pantallona gjithë baltë, me një xhakëtë të çuditshme, e palarë. Për flokët nuk kishte shumë rëndësi sepse ishin të shkurtër, prandaj edhe se nuk i krijha, njësoj dukeshin. Të emocionuar të gjithë bashkë në errësirë sajuam nga një karrige.

Kur filloi filmi, menjëherë na rrëmbeu, dhe ne u bëmë njësh me të. Aty qenë mishëruar të gjithë komponentët “të

shkrirë në një”. Dhe të gjithë në sallë ishim gjunjësuar, duke shijuar artin e vërtetë në filmin shqiptar. Vështrimi, regjia e Dh. Anagnostit, ishte i qartë, emocionues dhe bindës. Shquhej për thellësi mendimi, për një ngrohtësi në zbërthimin artistik të figurave. Ky film i realizuar me ndjenjë të thellë artistike, shënonte vendosjen në fondin e artë të kinematografisë shqiptare. Kur mbaroi filmi unë nuk e ndjeva lodhjen që kisha udhëtuar gjithë natën, përkundrazi ndjeva një çlodhje të bukur, çlodhje në lëvizje, çlodhje e mbushur me frymëzim. Dhe, kështu, filmi për mua u bë burimi i jetës. Në çdo gëzim, hidhërim, vuajtje, filmi qëndronte në qendër. Shumë shpejt u takova prapë me operatorin Saim Kokona. Ishte filmi artistik “Shpërthimet”, që xhironte regjisori Muharem Fejzo për pusët e naftës në Bishtin e Pallës.

Atë ditë deti ishte i qetë... Larg një burrë kishte hedhur grepin edhe peshkonte. Kishte vendosur në anë të detit një gur, pantallonat i kishte përveshur deri te gjuri, dhe i ulur peshkonte. Dita ishte e bukur. Pas kurrizit tonë, larg nesh shtriheshin fusha me misër të kooperativës që i tundte një flad i lehtë i verës. Kurse pranë nesh ishte e mbushur me lakra, që lëshonin një aromë të përzier me atë të bajgës. Në këtë vend ne xhironim çdo ditë. Dielli binte pingul mbi kokat tona, xhironim nga mëngjesi deri në pasdite vonë. Po drekë? E hanim bashkë drekë edhe darkë. Vetëm se na mbante gjallë humori i hollë i Saimit, që xhironte e xhironte, dhe më pas e këpuste një batutë, që na bënte të gjithëve të shkriheshim gazit të qeshnim me lot. Një ditë duke xhiruar, kur përfundoi plani, e drejtoi trupin lëshoi një: - Unë... - dhe theksoi:

- E shikoni këtë shkëmbim këtu?

Kureshtarë u afruam e i thamë:

- Po.

- Hë... ja, te ky shkëmbi këtu mua më arrestoi sigurimi i shtetit, sepse desha të arratisem!

Dhe ne ia shpërthyem të qeshurës me shpirt në atë vapën e madhe të muajit korrik. Por, atë ditë sapo mbërritëm në pikën e xhirimit, pas nesh mbërriti drejtori i filmit, Haxhi Dersha, zbriti nga makina dhe i shqetësuar theksoi:

- Më duket se do të na digjet dita e xhirimit.

- Pse? - tha Muharremi?

- Sepse pirotekniku është i sëmurë, me temperaturë të lartë.

- Obooboo!- u dëgjua zëri i Muharremit.

Eh, në këtë film rol të rëndësishëm zinin tymrat dhe flaka.

U afrua i gjithë grupi i filmit. Sytë e djemve shkëlqyen. Dita ishte e bukur - horizonti i detit ishte i qëruar. Të gjithë djemtë mësuan se, më në fund, do të bëhet një ditë pushimi. Muharremi tepër i merakosur m'u drejtua mua:

- Nuk duhet ta humbasim ditën e xhirimit...

Dhe unë e menduar ngrita supet.

Ai vazhdoi:

- Hë, Liri!...

E pashë drejt edhe në sy:

- E, çfarë duhet të bëjmë sipas teje?

Muharemi sikur u përmend:

- Po, ja, ndonjë nga djemtë...

Menjëherë ia thitha mendimin dhe iu drejtova grupit:

- Çuna duhet ta shpëtojmë ditën e xhirimit...

Nën zë pëshpëriti Gëzimi, operatori i zërit:

- Edhe nesër është ditë...

- Çfarë?

Të gjithë ulën kokat.

E hodha vështrimin te rekuizitieri, por edhe ai ngriti supet...

- Eh! - tha drejtori. - Nuk kemi se çfarë të bëjmë...

Shpërtheu një gëzim në sytë e të gjithë anëtarëve të grupit. Më në fund do të bëhej një ditë pushim. Por Muharremi vazhdonte dhe e mbante vështrimin me ngulm nga unë... E kuptova. Ai insistonte që dita e xhirimit të mos digjej. Dhe ja papritur më lindi një ide:

- Dakord, do t'i bëj unë tymrat.

Pati një reagim te të gjithë shokët që shpirtërisht qenë përgatitur për të bërë pushim. Kushedi sa shumë më mallkuan atë ditë nën zë.

Nuk vonoi shumë dhe unë përvështa mëngët. Mora të gjitha mjetet por, ah! Mungonin dorezat! Nuk e harroj atë ditë - ndeza tymrat dhe gjithë ditën u zhyta në helme - nuk arrita dot që të bëja të përsosurën dhe atë që desha, por me “sforco” bëra aq sa munda...

Por gabova!

Ato ishin “helme”. Kur u gdhi e nesërmja unë u ngrita e ënjtur në fytyrë si “tullumbace”. Vazhdova një javë të shkoja në xhirim me fytyrë të ënjtur dhe asnjëherë nuk shkova në ambulancë, nuk duhej të mungoja në xhirim.

Kjo ishte historia jonë!

Dhe, në këtë punë ansambël me grupet e filmave, ndieja dashuri dhe respekt. Atë dashuri që e kisha thithur bashkë me ajrin dhe djersën e ballit. Kjo më bënte optimiste që të ecja përpara. Por, kishte raste që edhe zemëroheshim ose ziheshim me njëri-tjetrin.

Ja, një herë ishim kthyer nga shërbimi të rraskapitur. Dhe, pas kësaj duhet të xhironim në dekor, në Kinostudio. Por ta dini ju xhirimet në Tiranë për ne ishin luks, pa mundime, pa

ecje orë të tëra në dëborë, në shi e stuhi. Dhe përveç krijuesve dhe kolektivit të Kinostudios, asnjë njeri tjetër nuk harronte ta kuptonte se me sa sakrificë ishte realizuar ai film. Në atë kohë shteti ynë kishte ngritur një grup njerëzish që quheshin “kontrolli punëtor”. Ky grup, në të vërtetë shtetëror, kishte kompetencë të plotë që të pushonte vetë njerëz nga puna. Dhe ne atë ditë xhironim në dekor. Erdhi kontrolli punëtor. Elektriciisti, Ladi kishte një trup mesatar, me sy të bukur bojë qielli me shikim të ngrohtë. Kur vendosi ndriçimin në rregull, po i vinte dekorit rreth e qark nga jashtë; mbante në dorë një shufër të vogël për t’u eglendisur, derisa të vinte koha e xhirimit. Kontrolli punëtor ia behu, u përball me Ladin që prekte muret me shufër.

Kontrolli punëtor:

- Çfarë bëni ju këtu?

Elektriciisti:

- Pallë ariu!...

Menjëherë njëri nga burrat nxori bllokun, lapsin dhe nisi të shkruajë:

- Si quheni?

- Vladimir...

Në moment kontrolli punëtor vajti fill e në drejtori. Atë ditë dhe në atë orë shkova edhe unë në drejtori, por nuk kisha nevojë t’i shpjegoja të gjitha, sepse drejtori i kuptonte më mirë se unë këto probleme. Kur u largova, i fola Ladi dhe i shpjegova se me njerëz të panjohur nuk flitet me këtë mirëbesim!... Ladi i vari turinjtë poshtë. Atëherë ishte i ri... Redaksia e filmit dokumentar ishte në katin e parë. Ajo ishte shumë e thjeshtë. Kishte një tavolinë të madhe dhe disa karrige të vendosura në të dyja krahët. Në një sergjen ishin vendosur dosjet e vjetra dhe të reja me skenarë.

Tavolina e madhe ishte e mbushur me lapsa, letra, gazeta etj. Ishte një dritare e madhe që shikimin e kishte nga oborri, nga ku hynin punonjësit e Kinostudios. Nuk e di, por diçka kishte ai oborr... Diçka melankolike... Nuk kishte drunj, vetëm lule dhe krijues, që ecnin lart dhe poshtë duke diskutuar për krijimtarinë e tyre e të shokëve. Ajo redaksi nuk kishte as edhe një zbukurim... ajo ishte e thjeshtë... por ama atë e mbushnin diskutimet e krijuesve me aromën e pasur dhe të mrekullueshme të tyre... Dhe ja, një ditë skenaristja e filmit dokumentar, Angjelina Xhara m'u afrua ashtu krejt papritur, e më tha:

- Liri kam një skenar dhe dëshiroj që ta realizosh ti...

- Si quhet skenari?

- "Me studentet ushtarake"... E kam shkruar së bashku me një oficer që quhet Fluturak Gërmenji, i cili e njeh mirë artin ushtarak.

- Jam dakord.

Angjelina, ashtu siç ishte impulsive, hapi çantën dhe nxori skenarin. E gëzuar ma dorëzoi skenarin. Unë ia lexova në sy gëzimin, ajo pati besim të plotë tek unë. Për momentin u hutova, por menjëherë u nisa te stacioni i autobusit. Fill kur mbërrita në shtëpi nisa leximin dhe stërleximin pa pushim. Të them të vërtetën, të gjithë u rritëm midis ndjenjash patriotike dhe për këtë të gjithë trashëgonim pak në atë kohë shpirtin e kundërshtimit. Kishte nga ata që u pëlqente komandimi dhe më pas ky soj kishte përfitime. Të tjerë studionin me pasion marksizëm-leninizmin, e, më pas, mësimet e tyre pretendonin se i vinin në jetë. Angjelina e kishte hapin shumë të shpejtë, kur ecte.

Ja, sikur e kam parasysh kur futej në oborrin e Kinostudios dhe menjëherë drejtohej nga redaksia. Angjelina ishte një

vajzë bionde. Simpatike. Trupin e kishte elegant, vishej me shije dhe ishte shumë praktike. Sapo ta takojë Angelina futej direkt në bisedë për filmat dhe skenarët. Jo, jo... asnjëherë nuk flisnim për kuzhinën, për gatimin, për veshjen etj. Angelina fliste me bindje të plotë, me të cilën donte të thoshte se “është vetëm kështu...”. E dini se kush ia prishte asaj? Vetëm Koleci (Traboini) që ishte kokëngjeshur. Nisëm diskutimet me Angjelinën për skenarin jo një herë dhe dy por disa herë...

Atë ditë po ecnim të dyja në drejtim të autobusit, dhe nuk po pushonim së diskutuari për skenarin. Por autobusi po vonohej si shumë. Angelina më tha të vazhdonim të ecnim dhe të qëndronim në stacione të tjera.

- Liri, duhet të shkosh në Shkollën e Bashkuar që t’i njohësh nga afër të gjitha studentet.

- Patjetër! Përpara se të filloj skenarin tekniko-regjisorial unë do të shkoj disa herë.

- E di, sa interesante është? Një nga këto oficeret e quajnë Zana Dema, nga Lezha dhe ka marrë pjesë në një film...

- Uuu, po... po e lexova!

- Po operatorin e ke menduar se kë do të marrësh?

- Posi jo, do ta xhiroj me Saim Kokonën, madje do të vijë edhe Pëllumb Kallfa.

Menjëherë Angelina psherëtiu thellë.

- Oh!... Sa bukur!...

Flisnim edhe nuk pushonim:

- Midis studenteve është edhe një poete... Ka botuar disa poezi.

Kishte nisur të binte një vesë shi i hollë, i cili nuk pushonte kurrë, kurse ne të dyja nuk e ndiem fare shiun në rrugën e gjatë që po ecnim në këmbë. Dhe papritur pamë piacën e

Tiranës të mbuluar nga një tis i hollë mjegulle, ku mbrapa saj shquhej si një shkabë e madhe e zezë busti i Skënderbeut. Kur mbërrita në shtëpi në heshtje mendoja: “Unë do t’i zbërthej bukur me poezi këto portrete, do të fut patjetër diçka të re ndryshe nga të tjerët, do të fut elementin artistik”. Dhe kështu bashkë me Saim Kokonën shkruam një skenar tekniko-regjisorial, me emocione dhe të bukur. Në mënyrë konkrete zbërthjem jetën e studenteve ushtarake, duke arritur deri në intimitete: në dhomat e fjetjes, në klasa, në stërvitje, në kohën e lirë... edhe pse tema ishte për ushtrinë, por aty nuk erdhi erë barut, armë, apo tym... Aty erdhi erë e freskët, e përzier me parfumin e luleve të moshës së re të studenteve. Nuk kaloi shumë dhe filluam xhirimet. Çdo ditë isha e emocionuar, po më shpaloseshin para syve ato që kisha menduar, avash-avash ishte futur elementi artistik. U skalitën këto figura me art dhe zunë një vend... një emër... në film. Akoma më shumë iu rritën vlerat filmit, kur xhiruam në dëborë në Malin me Gropa. U përplasëm me sakrificat e studenteve, me kushtet e vështira. Kur xhiruam flakën që shpërtheu në llogore midis dëborës, ajo nuk ishte ashtu thjesht “flaka e stërvitjes”. Ajo që “flakë me simbole” e ngritur në art. Ishte mendimi i Saimit që filmi të mbyllej me “zjarret partizane” të vendosura në dëborë në formë ylli. Saimi me mjeshtëri e mbylli filmin; u tërhoq me transfokator dhe në sfondin e natës, midis dëborës ndrisnin disa “yje” që simbolizonin “zjarret partizane”.

Dhe ja, filmi mbaroi. Besoj se të gjithë shokëve u kujtohen emocionet që na mbërthenin ditën që filmi do të shfaqej në kolektivin krijues. Sa bukur ishin të organizuara ato diskutime! Me një nivel të lartë artistik bëheshin të gjitha vërejtjet. Dhe më pas grupi realizues bënte korrigjimet e vërejtjeve. Dhe

përsëri udhëheqësi artistik kontrollonte korrigjimet. Atëherë çdo gjë ishte e saktë dhe këto ishin rregulla të prera për krijuesit e Kinostudios. Pas disa kohëve Viktor Gjika shkroi në revistën “Nëntori” analizën artistike të filmit dokumentar me titull “Të ngremë më lart nivelin ideo-estetik të filmit”. Ai, në boshtin e këtij shkrimi analizon filmat e mi për nivel të lartë artistik. Midis të tjerave për filmin “Me studentet ushtarake” nënvizonte:

“Skenari ‘Studentet ushtarake’ kishte një temë origjinale dhe të freskët, me autorë: Angelina Xhara dhe Fluturak Gërmenji. Këtë e ndjeu mirë grupi realizues: regjisore Liri Brahimi, operator Saim Kokona, Pëllumb Kallfa, që duke punuar me pasion dhe këmbëngulje realizuan një nga filmat më të bukur dhe më të freskët të vitit”.

Viktor Gjika ishte figura më e pastër dhe shembullore e kinematografisë shqiptare. Artisti që derisa mbylli sytë ruajti me dinjtet ‘linjën që i takonte’. Filmat e regjisorit Viktor Gjika kanë një tingëllim të veçantë. Dialogët e personazheve të tij janë të saktë, me tone të besueshme, me ngjyra dhe nuanca të ndryshme. Në të gjithë filmat e Viktorit pikasin historitë e karaktereve. Dhe, që të japësh bukur këtë dritë në film do të thotë që ta ndiesh atë. Pra ai ka vënë zemrën në krijimet e tij, duke ruajtur linjat e bukura të personazheve dhe qartësinë e mendimit.

Filmat: “I teti në bronz”, “Rrugë të bardha”, “Përballimi”, “Gjeneral gramafoni” etj. etj... sjellin mbresa të reja, të freskëta, një botë të tërë jetësore tepër të çuditshme, të ngritur në art. Kinostudio kishte fat që e kishte drejtor. Viktori kishte një karakter të butë. Nuk nxehej kurrë, asnjëherë nuk e ngrinte zërin dhe kurrë nuk e përplaste grushtin mbi tavolinë. Ishte i qetë... i butë... njerëzor!

E kam si tani parasysh portretin e bukur dhe zërin e tij imponues, një tingull i veçantë që sot është kthyer në një përrallë.

- Liri, shko dhe hiqi këto plane, se pastaj...

Kështu më shfaqet silueta e Viktorit në kujtesën time... Por jo... nuk është e vërtetë që ai nuk jeton... ai është këtu, midis të gjithë kineastëve... Viktor! Të duam të gjithë!... “Shkelim në gjurmët e tua të bukura...”

Dhe unë nuk pushoja së xhiruari. Por ama nuk ishte e lehtë që të xhiroja të gjitha ato që mendoja, sepse Shqipëria nuk ishte e tëra asfalt. Aq më tepër filmi dokumentar, ku akoma tingëllonte direktiva: “Duke pasqyruar në filmat tanë revolucionin, që thellohet dhe zhvillohet në mënyrë të sigurt, duke shënuar kalime cilësore dhe sigurisht te këta filma do të krijohen tablo të reja luftërash fitimtare” etj. etj.

Pas viteve të luftës së ftohtë të gjitha këto qëndronin bukur, por tani kishim hyrë në vitet ‘70 dhe patjetër duhet të futej një frymë e re... e ngadalshme, më bashkëkohore. Dhe ja një ditë... Një erë e tërbuar nisi të vërshëllente në të katërta anët e Kinostudios. Tundi ullishtat nga mbrapa ndërtesës, përplasi dërrasat e dekoreve, shkuli nga toka barin dhe guriçkat, me rrapëllimë po përplasheshin kapakët e drurit, të dritareve. Një stuhi e madhe, aq sa dukej sikur murrilani do ta përplaste ndërtesën përtokë. Nga thellësia, andej nga qendra nga “ndërtesa misterioze”, ngrihej një shpërthim, një jehonë që vinte nga zemra e Tiranës... sillte lajme... lajme të rrufeshme. Një tufë zogj të trembur fluturuan me rrëmbim. Në korridorin e Kinostudios dëgjoheshin hapa të shpejtuar këpucësh, që linin nga pas atë “ehon” e akustikës.

Ishte viti 1973.

Regjisori i filmit dokumentar Mit'hat Fagu xhiroi një film që i kushtohej revolucionit tekniko-shkencor. Ai po hapte një dritare, po sillte diçka të re... por... Kur u futa në sallë u afrova te shokët e mi që rrinin kokulur: Luani, Natasha, Vllasova, Nexhati, Ilia, Koleci, Angjelina etj. Pashë edhe një bllok krijuesish të vjetër, që e mbanin kokën lart. Çudi! Aty pranë ishte ulur edhe portieri i Kinostudios. Qëndrova ashtu e ngrirë dhe kisha frikë të lëshoja frymën. Me ngadalë e rrotullova kokën nga krahu i majtë i sallës dhe pashë në qendër persona të panjohur, që të përkushtuar diskutonin me zë të ulët me personat e drejtorisë. Ata kishin ardhur prej andej, e kuptoni vetë ju... Mit'hati nuk ishte në sallë. Çudi! Si ishte e mundur? Doja të pyesja por në sallë u fikën dritat.

Filloi projektimi i filmit. Të gjithë u kthyem në një gur, në atë heshtjen e thellë që e thyenin vetëm zërat e personave qeveritarë.

Projektimi i filmit mbaroi... Dritat u ndezën...

Menjëherë u ngrit sekretari i partisë. E tundi nja dy herë kokën, dhe me një zë të ashpër e protestues nisi të radhiste gabimet e regjisorit:

- Film i rrezikshëm! Kërkime novatore dhe të reja ne do të bëjmë, sepse duhet futur patjetër e reja në film, por ama krijuesi nuk duhet ta harrojë kurrë misionin e tij që është ndihmës i Partisë.

Nisi të ziente salla nga diskutimet e krijuesve, menjëherë pasoi zëri i veteranit Hamdi Ferhati:

- Rrymat e huaja mundet të luftohen, prandaj krijuesit duhet të kuptojnë mirë se vala e ndikimeve të huaja revizioniste nuk pushon së përplasuri në brigjet tona. Prandaj duhet t'u bëjmë

ballë me sa më shumë filma. Ku të militojnë për idealet e partisë dhe të revolucionit.

Tjetri: - Duhet e përgjithshmeja në art, dhe jo e veçanta...

Tjetri: - Filmat tanë duhet të ecin mirë me kohën dhe revolucionin etj. etj...

Asnjë krijues nuk iu kundërvu këtyre diskutimeve. Regjisori Mit'hat Fagu u dënua. E caktuan të punonte punëtor krahu në fabrikën e tullave. Në moment u tremba... u mblodha... m'u duk si një ëndërr e keqe... Seç më mbuloi një ndjenjë e turbullt si një vello trishtimi... Emocione që as vetë nuk arrija t'i kuptoja. Më dukej sikur dola e zhgënjyer nga ajo gjëja e re që doja të fusja në film. Gjithë ato drita që kisha ndezur... por ato ishin aty në tunelin e thellë... Dhe ja, tani më duken të gjitha një "hiç" duken gjëra romantike të moshës së rinisë, gjëra të pakapshme. Në moment e dini sesi m'u bë? Sikur ai "detaji artistik" më nxori gjuhën edhe më përqeshi: "ëëë...".

Në sallën e krijuesve diskutimet mbaruan. Mua më zgjoi nga meditim i skenaristja, Angjelina Xhara, e cila në moment m'u duk sikur kthehej nga një "kros" i gjatë. Me pasion më tha:

- Liri!

- Po.

- Kam gati një skenar tjetër.

Si e përhumbur e pyeta:

- Çfarë?

- Aaa... është portreti i një kryetare kooperative në Kutalli të Beratit - Natasha Hodaj, i thonë.

- Dakord, - ia miratova.

Një ditë shefi i redaksisë Kolec Traboini organizoi një mbledhje me skenaristët dhe regjisorët e sektorit të filmit

dokumentar. Vëmendja u përqendrua te “improvizimi”. Dhe, kjo ishte shumë e drejtë. Ne të gjithë, për të kujtuar një histori të kaluar, përdornim “improvizimin”. Por në shumicën e rasteve ky element i humbiste vlerat në film, sepse do ta kthente njeriun e thjeshtë të punës në rolin e aktorit. Dhe ky detaj i humbiste vlerat, emocionet fillonin e binin, zbeheshin. Prandaj improvizimi dhe kujtesa duheshin patjetër të futeshin në film, por ama të ecnin dhe të shkriheshin në një së bashku me të gjithë komponentët e tjerë, të ishin të besueshëm dhe jo teatralë. Diskutuan gjatë krijuesit dhe skenaristët e vjetër me eksperiencë si: Muharrem Skënderi, Niko Koleka etj. etj. Dhe kështu ata e përqendruan vëmendjen te skenarët, te vërtetësia e tyre. Të gjithë binin dakord gjithmonë në vija të trasha për të futur elementin e ri artistik në filmin dokumentar. Por ama kur afronte fundi i mbledhjes skenaristët e vjetër e mbyllnin mbledhjen përsëri me ato “rrënjët e para”, që kishte hedhur kinematografia shqiptare.

Pas ca kohëve iu përvësua me pasion për ta studiuar skenarin e ri të Angjelina Xharës “Një ditë në Kutalli”. Autorja e kishte zgjedhur drejt dhe saktë portretin e kryetares Natasha Hodaj, që duke e vendosur midis kooperativistëve, ajo bëhet një “shtytëse” për transformime të mëdha në kooperativën e bashkuar në Kutalli-Berat. Mora operator Rakip Zenelin. U nisëm urgjent në vendin e caktuar për të verifikuar çdo gjë. Kur mbërritëm në fshat ishte një vapë e madhe dhe në sfond afrohej një mjegull e bardhë nga tokat e punuara. E ndaluam makinën pranë një kanali ku punonin dy kooperativistë. Ata po hapnin kanalin që ishte mbushur me shkarpa edhe me gurë. Të bërë qull në djersë dolën nga kanali dhe me një gojë të ëmbël menjëherë na përshëndetën dhe zgjatën dorën:

- Mirë se erdhët!

Dhe, me buzë në gaz, u përgjigjëm:

- Mirë se ju gjetëm!

Unë menjëherë ia ngula sytë një teneqeje me ujë që ishte në anë të kanalit. U afrova te teneqja dhe po e shikoja me vëmendje, në fund ishte gjithë ndryshk. Aha... nuk m'u durua më gjatë!

- Të lutem a mundet të pimë nga ky uji?!

- Qysh jo ori, por kujdes sepse gotë nuk kemi.

Nuk u menduam më gjatë Rakipi, shoferi Çimi dhe unë ua mbaruam të gjithë ujin. Pashë nga fshatarët:

- Ua! Mbaroi i gjithë uji...

- S'ka gjë, mos u shqetëso vemë prapë e mbushim...

Në moment u preka e hodha shikimin larg dhe poshtë... mendova duke hequr në zemër: "Sa zemër të madhe që ka fshatari, e heq kafshatën e bukës nga goja për mikun. Por qytetari gjithmonë gabonte për fshatin. Nuk e dinin dhe nuk e çmuan kurrë se sa shumë e vështirë ishte puna e tyre. Dhe kjo vinte sepse nuk e kishin provuar jetesën në fshat. E merrnin fshatin si vend pushimi, i qetë dhe i mirë, ku pihej uji i burimeve akull i ftohtë, qumështi i freskët, kosi, dhalli, ku hahej mish i pjekur në hell. Dhe kështu, qytetari e shikonte fshatin si vend piktoresk ku kaloheshin bukur pushimet verore, qytetari kishte të tjera pikëpamje për fshatin".

U nisëm me makinë nëpër fusha. Qetësia ishte absolute. Nuk dëgjohej asnjë zhurmë. Kooperativistët po bënëin pushimin e drekës. Fshati ishte i zhveshur pa pemë. Prandaj nuk dëgjohehin cicërimat e zogjve dhe as lehjet e qenve. U hodha shikimin fushave. Hapësira vinte në një formë të çuditshme. Ja, aty te kthesa fusha bënte një si dredhë, dhe aty

jeta rridhte ndryshe, edhe pulsi kishte tjetër ritëm. Dukej sikur e kishte mbërthyer me shekuj dhe me vite mjegulla. Por ama dielli ndriçonte...

Ja, aty larg gumëzhinte traktori dhe tokat punoheshin. Kurse më poshtë plekseshin tufa-tufa fluturat e vogla të bardha me një kope mushkonjash. Fushat ishin pa mbarim të mbushura me misër ku midis tyre flakërinin edhe lulëkuqet. Më në fund, qëndruam në qendër. U drejtuam në shtëpinë e kryetares së kooperativës, Natasha Hodaj. Sapo u futëm u befasuam. Më bëri përshtypje mënyra e mobilimit, këtu kishte nisur të hynte diçka e re, e bukur, e pastër... vinte era qytetërim. Atë ditë na mbajtën në shtëpinë e tyre, edhe ne patëm rastin më të mirë për t'u njohur me problemet e kooperativës.

Ishte një çift i bukur. Ua ngula sytë dhe nisa t'i pyes.

- Po ju ku jini njohur?

- Në universitet...

- Po pse edhe ju keni mbaruar Agronomi?

- Po... po... që të dy kemi mbaruar të njëjtën degë.

Dhe më poshtë Bahriu vazhdoi:

- Unë punoj te zyrat e kooperativës, kurse Natasha drejton direkt prodhimin e kooperativës.

Eh! Sa bukur e argumentonin Bahriu dhe Natasha punën e palodhur të kooperativistëve, që gjithë ditën u digjej koka në diell, kurse në dimër u ngrinin këmbët dhe u bëheshin dru nga era dhe stuhia që fshikullonte pa pushim në fushat e Kutallisë.

Dhe më poshtë Bahriu tepër impulsiv vazhdonte:

- Tani kemi në diskutim problemin e impianteve të ujit për ujitjen e tokave.

Sakaq plotësoi Natasha:

- Kooperativistët me përvojë ngulin këmbë se impiantet duhet të ndërtohen në formë rrethore, në të gjithë sipërfaqen e tokave.

Bahriu ndërhyri:

- Ua argumentuam në formë shkencore që kjo ishte më ekonomike dhe forma më e përsosur, më produktivja, dhe që arrinte ta ujiste të gjithë sipërfaqen.

Ne të çuditur shikonim çiftin se me sa pasion flisnin për punën e tyre. Ata nuk gjenin dot pushim për të marrë frymë lirisht. Natasha fugonte pas traktorëve, shirjeve e mbjelljeve. Kurse Bahriu sa te zyrat në fushë e anasjelltas.

Që të realizosh një portret në filmin dokumentar nuk është e lehtë. Diskutova shumë me operatorin dhe mbi të gjitha mendoja që të fusja diçka të re dhe të veçantë. Por kuptova se operatorët e dokumentarit kishin stilin e tyre të xhirimit dhe nuk donin kurrë të largoheshin nga metodat stereotipe të tyre. Vazhdonin duke mbrojtur idenë se filmi dokumentar është thjesht një dokument që duhet pasqyruar në formë realiste. Atë natë kaluam bukur. Papritur Natasha më pyeti për origjinën e prindërve:

- Liri, me origjinë ti nga je?

- Jam lindur dhe rritur në Tiranë, sepse prindërit e mi kanë ardhur shumë të rinj, nga vitet 1930 në këtë qytet, por origjina e prindërve të mi është fshati Brataj-Vlorë.

Natashën sikur e zuri korrenti, me rrëmbim u ngrit në këmbë duke nxjerrë pasthirmën:

- Ua! Ua!...

Unë dhe Rakipi të çuditur po e shikonim. U drejtua nga unë:

- Edhe unë jam nga i njëjti vend.

- Çudi! Koincidencë, - i thashë unë.

- Po ju Rakip, nga jeni?

- Unë jam pak më poshtë sesa juve, nga Kuçi...

Të gjithë këtë të papritur e theu Bahriu, i cili na kishte mbushur me birrë gotat:

- Ta pimë me fund për Labërinë!

- Gëzuar!

- Gëzuar!

U kthëm në Tiranë të frymëzuar dhe të bindur që në skenarin tekniko-regjisorial do të shkruanim vlerat e skenarit letrar e do t'i ngrinim akoma më shumë. Natasha kishte portret të bukur, peizazhi ishte i bukur. Pra ishin dy elemente kryesore që shkriheshin në një.

Atë ditë që po shkruanim, unë kisha menduar që në film të fusja një ëndërr. Dhe në këtë mënyrë gërshetohej me punët në kooperativë, që vinin në rritje, ku realizoheshin të gjitha metodat e fundit të shkencës në bujqësi. Në moment, kur po shkruanim e ndërpreva shkrimin, ula lapsin, u ngrita në këmbë dhe nisa t'ia demonstroj operatorit:

- Dëgjo... shiko sa bukur tingëllon...

Me bisht të syrit po ndiqja vështrimin e tij, se çfarë përshtypje po i krijonte ky element artistik, e vazhdova:

- Hëna vezullonte në...

Por... jo... jo... asgjë, ia thitha të gjithë mendimin. Ai menjëherë u zgjua dhe ma preu hovin:

- Jo! Jo! Vazhdo më poshtë me stendën e emulacionit socialist; nuk venë këto gjëra për fshatin. Ne kemi ardhur të xhirojmë punët e agronomes.

Operatorët e filmit dokumentar dhe të gjithë krijuesit e këtij sektori punonin me përkushtim, por gjithmonë sipas metodës

së vjetër të tyre, dhe prodhimentaria e filmave dokumentar nuk kishte asnjëherë kthim mbrapsht. Për krijuesit ky ishte ligj i prerë sepse i kishte hedhur rrënjët qysh në fillim dhe ishte tepër e vështirë që t'i shkulte. Dhe më poshtë operatori vazhdoi:

- Ne, Liri duhet të xhirojmë sukseset e arritura pas Plenumit të IV.

- Dakord, por ne duhet ta alternojmë këtë sukses në formë artistike me portretin.

- Liri! Dëgjo këtu ky është film dokumentar...

- Dakord... Por edhe dokumentari ka emocione...

Eh! E pashë se ishte çdo gjë e kotë... Ula kokën poshtë dhe nën zë theksova: “Liri, lëre me kaq”.

Unë nga filmi përvetësova artin e kompozimit, jo nga historia çfarë përmbante filmi, por nga vetë ekzistenca e filmit si një vepër. Ne përpiqeshim, zbulonim, kërkonim... por as vetë nuk e dinim se çfarë zbulonim. Kjo ishte një “hiç”. Filmi “Një ditë në Kutall” me skenar të Angjelina Xharës u prit shumë mirë nga kolektivi krijues. Aty u shpalos qart mendimi se portreti i Natasha Hodaj është në qendër dhe sukseset e arritura në bujqësi janë jeshillëqet që rrethojnë këtë buqetë të madhe dhe të bukur të filmit. Atë natë isha e shtrirë në krevat. Dhe ja, nata pasonte natën, veçse kjo natë sikur ishte ndryshe nga të tjerat. Edhe pse isha e zgjuar unë vazhdoja ëndërrimin. Sepse kur është dita e ngre kollaj murin ndarës të syve me botën e përtejme. Ah! Por kur vjen nata ajo shkrihet vetëm në një - errësirë. Dhe në errësirë ndodhin të gjitha: rrotat e makinës rrëshqasin, trenat përplasen, dhe njeriu nuk komandon më dot asgjë... është i dorëzuar. Atëherë e kaluara afrohet duke u ngritur në piedestal... dhe dorëzohesh. Nisin historitë njëra pas tjetrës. Ah!... Do t’u tregoj një histori...